VENDIM
Nr. 234, datë 18.8.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E HIPOTEKËS MBI ASETET E SHOQËRISË "IDI 2005" SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a" dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të neneve 4, germa "b", nenit 6, 7 dhe 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1959/9 prot., datë 14.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'IDI 2005' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj 'Intesa SanPaolo Bank Albania' sh.a.",

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 27.3.2024, nga HEC "Arçov" me kapacitet të instaluar 1.28 mw, me vendndodhje në përroin e Arçovës, degë e përroit të Selcës dhe të Holtës, me derdhje në lumin Shkumbin, qarku Elbasan.
- Me nr. 1959 prot., datë 25.6.2026, shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të HEC "Arcovë", si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 13.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë. Për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195/2026, ERE ka njoftuar dhe MIE-n nëpërmjet shkresës nr. 1959/2 prot., datë 16.7.2026.
- ERE, me shkresën nr. 1959/3 prot., datë 17.7.2026, *email*-in e datës 28.7.2026, shkresën nr. 1959/6 prot., datë 31.7.2026 dhe *email*-in datë 4.8.2026, ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 195/2026, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar në këtë aplikim.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Në përgjigje, me shkresat nr. 1959/5 prot., datë 28.7.2026 dhe nr. 1959/8 prot., datë 5.8.2026, shoqëria ka përcjellë sa kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon:
- Neni 4, germa g – për HEC-et me fuqi të instaluar më të vogël se 5 mw, kërkohet miratimi i ERE nëse vlera e aseteve që transferohen është më e madhe se 50.000.000 lekë (pesëdhjetë milionë).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- germa "a" – Është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- germa "b" – Është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- germa "c" – Është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa "d" – Është bërë një përshkrim i kandidatit;

- germa "e", "f" dhe "g" – Arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- germa "h" – Janë depozituar kontratat/marrëveshjet përkatëse;

- "Kontratë kredie bankare" nr. 4995 rep., nr. 3372 kol., datë 30.8.2025, nënshkruar nga palët, që do të shërbejë për financimin e investimit në ndërtimin e hidrocentralit "Arçova HPP" me kapacitet 1.28 mw, dhe rimbursimin e fondeve të kredimarrësit (ortakëve/shoqërive të grupit), lidhur me ndërtimin e HEC "Arçova HPP", duke ruajtur në masën 62%/38% (përfshirë TVSH-në) ndërmjet financimit të bankës dhe kapitalit të pjesëmarrjes së ortakëve.

- Kontratë hipoteke nr. 5002 rep., nr. 3379 kol., datë 30.8.2025, me anë të të cilës është rënë dakord të vendoset në favor të bankës një hipotekë e radhës së parë mbi "Pasuritë e paluajtshme të ardhshme dhe/ose prona".

- germa "i" – Deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- germa "j" – Deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse;

- Pika 3 – Është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferohen te përfituesi, përfshirë edhe informimin e autoritetit shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve;

- Pika 4 – Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit;

- Pika 6 – Shoqëria ka bërë me dije se nuk ka pjesë të dokumentacionit në këtë aplikim që konsiderohet se nuk duhet të jetë i hapur për publikun.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. dhe në referencë të kërkesave të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se shoqëria ka përmbushur kërkesat përkatëse për dhënien e autorizimit nga ERE, lidhur me vendosjen e hipotekës mbi asetet që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sha (për kontratën e

kredisë nr. 4995 rep., nr. 3372 kol., datë 30.8.2025 dhe kontratë hipoteke nr. 5002 rep., nr. 3379 kol., datë 30.8.2025).

2. Shoqëria të depozitojë në ERE menjëherë pasi të disponojë listën e aseteve të paluajtshme (si aneks/pjesë integrale të kontratës së hipotekës) të lëna kolateral pranë "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a., në vijim të regjistrimit të pronësisë mbi hidrocentralin "Arcova HPP".

3. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje përfshirë transferimin tek të tretët.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 2 dhe 4, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar, datë 2.11.2021 apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k., "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti